

VENDIM
Nr. 19, datë 7.7.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare
Marsida Xhaferllari,	anëtare
Fiona Papajorgji,	anëtare
Sonila Bejtja,	anëtare
Altin Binaj,	anëtar
Sandër Beci,	anëtar
Elsa Toska,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.6.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 1(O) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: ODISE XHELITA

SUBJEKT I INTERESUAR: BANKA E SHQIPËRISË

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 4, pika 1, 11, pika 3, 15, 17, pika 1, 18, pikat 1 dhe 2, 35, pika 3, 41, pika 1, 42, 43, 116, 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, pika 2, 27, 39, 71, 71/a dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarit Odise Xhelita, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.7.2010 kërkuari dhe shtetasja L.Z., në cilësinë e kredimarrësve, kanë lidhur me ish-Bankën Kombëtare të Greqisë (banka NBG), dega Tiranë, në cilësinë e kredidhënësit, kontratën nr. 3059 rep., nr. 790 kol., në shumën 29.300 euro për blerje apartamenti.

2. Marrëdhënia juridike e kontratës së kredisë ka përfunduar për shkak të shlyerjes së saj para afatit të kohëzgjatjes. Përpara shlyerjes së parakohshme të kredisë, kërkuari i është drejtuar me kërkesë Bankës së Shqipërisë për të ndërhyrë nëpërmjet veprimeve korrigjuese, për shkak se NBG-ja kishte refuzuar të reduktonte interesat dhe kostot e aplikuara për pjesën e pashlyer të kredisë për periudhën e mbetur sipas kontratës, penaltitetet për shlyerjen e parakohshme të kredisë, penaltitetet për mosndryshim të kolateralit dhe shpenzimet për sigurimin e jetesës e të pronës për periudhën pas shlyerjes së detyrimit, duke shkelur kështu legjislacionin bankar.

3. Me shkresën nr. 264/1 prot., datë 17.1.2014, Banka e Shqipërisë ka informuar kërkuarin, ndër të tjera, se, referuar nenit 31 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9662/2006*), rishikimi i kushteve të kontratës në rastet e shlyerjes së parakohshme të kredisë është e drejtë e bankës tregtare që e ka dhënë atë, se kredia për të cilën ka

aplikuar klasifikohet si kredi hipotekore dhe jo konsumatore, së cilës i referohet ai, dhe se pas kërkesës së Bankës Kombëtare të Greqisë drejtuar kompanisë “Interalbania” sh.a., primi i policës së sigurimit i është kthyer në datën 6.12.2013.

4. Në datën 29.1.2014 kërkuesi i është drejtuar me ankesë Bankës së Shqipërisë ndaj shkresës së saj nr. 264/1 prot., datë 17.1.2014, ndërsa në datën 12.3.2014 me kërkesë për pajisje me dokumentacion, konkretisht kopje të vërtetuara të të gjithë praktikës së administruar pranë saj në lidhje me procedimin administrativ të iniciuar prej tij dhe shtetas L.Z., në cilësinë e kredimarrësve, duke përfshirë në veçanti aktet dhe dokumentacionin e rezultuar si pasojë e inspektimit të kryer.

5. Në përgjigje të kërkesës së tij për pajisje me dokumentacion, me shkresën nr. 644/1 prot., datë 25.3.2014, Banka e Shqipërisë ka informuar kërkuenin se konkluzionet e rezultuara nga procesi mbikëqyrës i ushtruar ndaj NGB-së i janë vënë në dispozicion me shkresën nr. 264/1, datë 17.1.2014 të saj, dhe se komunikimet mes Bankës së Shqipërisë dhe bankës përkatëse kanë karakter konfidencial dhe nuk mund t’u vihen në dispozicion personave që nuk e gëzojnë këtë të drejtë me ligj.

6. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur, që në ushtrim të funksionit të saj, të kryejë veprimin administrativ të realizimit të procesit të mbikëqyrjes në lidhje me kontratë kredie nr. 3559 rep., nr. 770 kol, datë 22.7.2010 të lidhur me “Banka NGB Albania” sh.a., nëpërmjet kryerjes së inspektimit të plotë, të konstatimit të veprimeve në kundërvajtje, si dhe të kryerjes së veprimeve korrigjuese, duke marrë masat përkatëse mbikëqyrëse në përfundim të këtij procesi. Detyrimin e palës së paditur për të më pajisur me informacionin dhe dokumentet e përdorura në procedurën e mbikëqyrjes”*, për të cilën gjykata, me vendimin nr. 11, datë 17.7.2014, ka vendosur rrëzimin e saj.

7. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021, ka vendosur mospranimin.

8. Në datën 11.2.2022 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Lartë. Në kërkesë ai ka kërkuar edhe thirrjen si subjekt të interesuar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*), i cili, sipas tij, për shkak të përgjegjësisë dhe kompetencave ekskluzive që ka për të inspektuar veprimtarinë institucionale të Gjykatës së Lartë, mund të kontribuojë në çështje.

9. Në datën 18.3.2022 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh. Gjykata ka vlerësuar të mos thërrasë *ILD*-në si subjekt të interesuar në gjykim, pasi ky subjekt nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe thirrja e tij nuk paraqet interes për gjykimin kushtetues të çështjes (*shih vendimin nr. 37, datë 5.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, procesi disiplinor i iniciuar nga kërkuesi në *ILD* ndaj gjyqtarit relator në Gjykatën e Lartë, si dhe ai gjyqësor janë konkurrues, në kuptimin që mund të vazhdojnë njëkohësisht.

10. Në datën 29.3.2022 kërkuesi i është komunikuar shkresa e datës 23.3.2022 e Gjykatës, për njoftimin e kalimit të çështjes së tij për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, si dhe të drejtën e palëve në gjykim për të paraqitur pretendimet me shkrim brenda datës 22.4.2022. Në datën 22.4.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shtyrjen e afatit të parashtrimeve, ndërsa në datën 2.6.2022 ka paraqitur pretendimet e tij me shkrim.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi** ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se i janë cenuar:

11.1 *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi:

11.1.1 Duke arsyetuar për ligjshmërinë e ekzekutimit të kontratës së kredisë, gjykatat janë shprehur edhe për të drejtën subjektive të pronësisë, e cila është në kompetencë të gjykatave civile.

11.1.2 Në aktet e dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë nuk rezultojnë procedurat e shortit për caktimin e trupit gjykues në zbatim të vendimit nr. 47, datë 1.4.2021 të këshillit të kësaj gjykate “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të secilit kolegji” (vendimi nr. 47/2021), çka përbën një garanci procedurale të munguar. Për më tepër, vendimi nr. 47/2021 e kishte humbur fuqinë me emërimin e dy gjyqtarëve të rinj dhe, për rrjedhojë, nuk sillte pasoja juridike.

11.2 *E drejta e aksesit*, pasi aktet e ndodhura në dosjen e Gjykatës së Lartë bien ndesh me përcaktimet e nenit 4, pika 1, të Kushtetutës, me nenet 15, 36 dhe 92 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” (ligji nr. 9154/2003), me normat tekniko-profesionale dhe metodologjinë e shërbimit arkivor, si dhe me vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” (vendimi nr. 4/2017) të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave. Shkelja e standardeve për numërtimin, evidentimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e akteve, e kryer në kundërshtim me parimet e transparencës, gjurmueshmërisë e monitorimit të procesit në Gjykatën e Lartë dhe me nenin 42 të Kushtetutës, i ka kufizuar të drejtën e aksesit, duke e detyruar të paraqesë kundërshtimet e tij vetëm mbi bazën e akteve të inventarizuara në dosjen e Gjykatës së Lartë.

11.3 *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, për shkak të shkeljes së standardeve për numërtimin, evidentimin dhe sistemimin e akteve në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë, çka ka bërë që kjo gjykatë të mos japë garanci të mjaftueshme procedurale për të shmangur çdo dyshim të arsyeshëm për paanshmërinë e saj, si dhe për shkak të mungesës së procedurave të shortimit mes trupave gjykues nr. 1 dhe nr. 2 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të përcaktuar në vendimin nr. 47/2021 të Këshillit të Gjykatës së Lartë.

11.4 *E drejta për t’u dëgjuar*, pasi relacioni i gjyqtarit për shqyrtimin paraprak të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përmban datë ose të dhëna nëse u është shpërndarë edhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, ndërkohë që gjykimi i çështjes vlerësohet të jetë kryer në një hapësirë kohore prej 10 minutash. Po kështu, referimi i Gjykatës së Lartë në jurisprudencën e saj pa cituar vendimarrje konkrete i ka cenuar të drejtën për të debatuar për këto vendime, për rrjedhojë për t’u dëgjuar.

11.5 *Parimi i barazisë së armëve*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh shtesën e rekursit të tij, të regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 2861 prot., datë 31.8.2021, duke lejuar të prevalojnë argumentet e palës kundërrekursuese. Po kështu, kundërrekursi nuk rezulton i dokumentuar në listën e akteve të administruara në dosje ose t’i jetë dorëzuar relatorit të çështjes dhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues.

11.6 *Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi në ndryshim nga çështjet e tjera të shqyrtuara në të njëjtën ditë nga Gjykata e Lartë, çështja e tij është gjykuar tej një afati të arsyeshëm.

11.7 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për bazueshmërinë në ligj të qëndrimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk ka përfshirë në vendim nene që reduktimin e kostove të kredisë e njohin si për kredinë konsumatore, ashtu edhe për atë hipotekare, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij se Gjykata Administrative e Apelit ka keqzbatuar kuadrin ligjor në fuqi, duke ngatërruar subjektet të cilave u drejtohet neni 91 i ligjit nr. 9662/2006, në cenim të së drejtës për informim. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk ka interpretuar as literalisht nenin 91 të ligjit nr. 9662/2006 në drejtim të subjekteve që u drejtohet, kufizimeve që vendos në lidhje me informacionin e kërkuar, si dhe subjekteve përfituese të informacionit. Për rrjedhojë, proceduralisht, kjo gjykatë nuk ka ushtruar funksionin e saj ligjor rishikues. Vendimi i saj është kontradiktor, jologjik dhe nuk përmban referenca ligjore dhe jurisprudenciale. Mungesa e arsytimit të vendimit gjyqësor ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike.

11.8 *E drejta për t’u njohur me të dhënat personale*, e garantuar nga neni 35, pika 3, i Kushtetutës, pasi, pavarësisht kërkesave të tij, Banka e Shqipërisë nuk e ka informuar për të dhënat e rezultuara ndaj tij në përfundim të procesit të mbikëqyrjes së veprimeve të ish-Bankës Kombëtare të Greqisë.

11.9 Zbatimi i keq i ligjit për shkak se memo-ja e përgatitur nga Zyra e Përputhshmërisë, PPT/Transparencës, Sektori i Mbikëqyrjes, drejtuar drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, është hartuar pa u ushtruar përgjegjësitë dhe pa u marrë vendim nga drejtori i këtij departamenti, sipas parashikimeve të pikës 3 të vendimit nr. 5, datë 11.2.2009 “Për miratimin e rregullores për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët” (vendimi nr. 5/2009) të Bankës së Shqipërisë.

12. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuarit si vijon:

12.1 Kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12.2 Në kundërshtim me sa pretendon kërkuari, ligji nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012) dhe Kodi i Procedurës Civile (KPC) nuk përmbajnë përcaktime në lidhje me shortin. Pretendimet e tij kanë të bëjnë me mospërputhjen e akteve të brendshme të Gjykatës së Lartë me ligjin nr. 9154/2003 dhe aktet e tjera nënligjore, çka nuk përbën shkelje kushtetuese.

12.3 Banka NBG Albania sh.a. është blerë dhe përthithur nga Banka Amerikane e Investimeve, sh.a. Po kështu, kërkuari e ka shlyer kredinë ndaj asaj banke dhe detyrimi është mbyllur që prej 9 vjetësh. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë nuk mund të ushtrojë më asnjë kompetencë mbikëqyrëse e, për rrjedhojë, kërkesa e kërkuarit e ka humbur objektin. Për më tepër, Banka e Shqipërisë e ka luajtur rolin e saj mbikëqyrës, pavarësisht se konkluzionet nuk kënaqin interesat e kërkuarit.

12.4 Pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi në pikat 8, 9 dhe 10 të vendimit të saj Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje për shkaqet e mospranimit të rekursit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendimet në Gjykatë, ndaj provon interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

16. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me shterimin e mjeteve juridike efektive. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në

substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, kërkuksi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi në krahasim me çështjet e tjera të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë në të njëjtën ditë, çështja e tij është shqyrtuar tej një afati të arsyeshëm. Gjykata vlerëson të analizojë këtë pretendim në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Gjykata vëren se këtë standard kërkuksi e ka parashtruar drejtpërdrejt përpara saj, pa shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive në dispozicion të tij, sipas neneve 399/1 – 399/12 të KPC-së. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, Gjykata ka pranuar se në parim mjetet e parashikuara nga neni 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim Gjykata çmon se kërkuksi nuk ka shteruar mjetet efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P” të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

18. Në vijim, Gjykata konstaton se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pretendimet e tjera kërkuksi i ka ngritur, në thelb, përpara këtyre gjykatave. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata vëren se vendimi më i fundit në kohë është ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i datës 16.9.2021, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 11.2.2022. Në lidhje me këtë fakt, kërkuksi ka pretenduar se vendimi gjyqësor i arsyetuar i është njoftuar në datën 11.10.2021, ndërsa subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka pretenduar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

20. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se në zbatim të nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe pikës 4 të vendimit nr. 131, datë 2.7.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve” të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë (*urdhri nr. 131/2021*), në datën 2.8.2021 sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka njoftuar, përmes shpalljes në faqen zyrtare të gjykatës, datën e shqyrtimit të çështjes së kërkuksit, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Po kështu, në zbatim të pikës 5 të urdhrit nr. 131/2021, për njoftimin elektronik të akteve, në datën 11.10.2021 kërkuksit i është bërë me dije vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë në mënyrë elektronike nga sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate (*shih dosjen gjyqësore nr. 1362, datë 16.9.2021 të Gjykatës së Lartë, faqet 7-9 dhe 22*). Për rrjedhojë, në kushtet kur pretendimet e kërkuksit lidhen edhe me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

21. Për sa i takon legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuksi ka parashtruar një sërë pretendimesh, si cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t’u dëgjuar, parimit të barazisë së armëve, standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe së drejtës për t’u njohur me të dhënat personale. Po kështu, ai ka pretenduar se është zbatuar keq ligji, për shkak të mënyrës së hartimit të memos nga Zyra e Përputhshmërisë, se kundërrkursi nuk rezulton i dokumentuar në listën e akteve të administruara në dosje ose t’i jetë dorëzuar relatorit të çështjes e anëtarëve të tjerë të trupit gjykues,

si dhe se nuk janë zbatuar normat tekniko-profesionale dhe metodologjia e shërbimit arkivor në evidentimin e dosjes gjyqësore për çështjen e tij (*shih paragrafët 11.1.-11.9 të vendimit*).

22. Sipas subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, Banka NBG Albania sh.a. është blerë dhe përthithur nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a., kërkuesi e ka shlyer kredinë ndaj asaj banke dhe detyrimi është mbyllur që prej 9 vjetësh. Në këto kushte, ajo nuk mund të ushtrojë më asnjë kompetencë mbikëqyrëse, për rrjedhojë kërkesa e kërkuetit e ka humbur objektin e saj. Për më tepër, Banka e Shqipërisë e ka luajtur rolin e saj mbikëqyrës, pavarësisht se konkluzionet nuk kënaqin interesat e kërkuetit.

23. Gjykata vlerëson se për sa kohë që procesi i themelit të çështjes ka të bëjë me veprimet/mosveprimet administrative të Bankës së Shqipërisë, për ndërhyrje përmes veprimeve rregullatore, si dhe procesin administrativ të zhvilluar prej saj, të cilin kërkuesi e ka kundërshtuar në gjykatë, pretendimet e subjektit të interesuar lidhur me humbjen e objektit të çështjes janë të pabazuara.

24. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimi i zbatimit keq të ligjit, për shkak të mënyrës së hartimit të memos nga Zyra e Përputhshmërisë, ka të bëjë me çështje të interpretimit të ligjit dhe, si i tillë, nuk përbën juridiksion kushtetues. Ndërsa, për pretendimin se kundërrekursi nuk rezulton i dokumentuar në listën e akteve të administruara në dosje ose t'i jetë dorëzuar relatorit të çështjes e anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, Gjykata çmon se argumentet e parashtruara janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për më tepër, pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si dhe së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e moszbatimit nga Gjykata e Lartë të normave tekniko-profesionale dhe metodologjisë së shërbimit arkivor në evidentimin e dosjes gjyqësore për çështjen e tij, mungesës së të dhënave nëse relacioni i gjyqtarit për shqyrtimin paraprak të çështjes i është shpërndarë gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Administrativ të asaj gjykate, prezumimit se çështja është shqyrtuar në një hapësirë kohore prej 10 minutash dhe moscitimin në vendimin e Gjykatës së Lartë të vendimmarrjeve konkrete të saj, Gjykata vlerëson se nuk janë ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk do të ndalet në shqyrtimin e tyre.

25. Lidhur me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak të moshedhjes së shortit të ri nga Gjykata e Lartë dhe të standardit të arsytimit të vendimit të kësaj gjykate, Gjykata vëren se këto pretendime janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë do t'i shqyrtojë në vijim. Po ashtu, ajo thekson se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës për t'u njohur me të dhënat personale, për shkak se Banka e Shqipërisë nuk e ka informuar për të dhënat e rezultuara ndaj tij në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, si dhe të parimit të barazisë së armëve, për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh shtesën e rekursit të tij, në zbatim të parimit *iura novit curia* do t'i analizojë në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

26. Kërkuesi ka pretenduar se duke arsyetuar për ligjshmërinë e ekzekutimit të kontratës së kredisë, gjykatat janë shprehur edhe për të drejtën subjektive të pronësisë, e cila është në kompetencë të gjykatave civile. Po sipas tij, nga aktet e dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë nuk rezultojnë procedurat e shortit për caktimin e trupit gjykues, në zbatim të vendimit nr. 47/2021 të këshillit të kësaj gjykate, çka përbën një garanci procedurale të munguar. Për më tepër, vendimi nr. 47/2021 e kishte humbur fuqinë me emërimin e dy gjyqtarëve të rinj dhe, për rrjedhojë, nuk sillte pasojë juridike.

27. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka pretenduar se në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, ligji nr. 49/2012 dhe KPC-ja nuk përmbajnë përcaktime në lidhje me shortin. Pretendimet e tij kanë të bëjnë me mospërputhjen e akteve të brendshme të Gjykatës së Lartë me ligjin nr. 9154/2003 dhe aktet e tjera nënligjore, çka nuk përbën shkelje kushtetuese.

28. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit. Këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se kompetenca dhe juridiksioni i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes së kërkuarit janë parashikuar në nenin 141 të Kushtetutës, ligjin nr. 49/2012 dhe ligjin nr. 98/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*). Vendimi nr. 47/2021 i Këshillit të Gjykatës së Lartë është bazuar në pikat 2 e 3 të nenit 23 dhe shkronjën “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016, që parashikojnë krijimin në çdo gjykatë të seksioneve dhe trupave gjykues, sipas rregullave të parashikuara në ligjin procedural, si dhe caktimin në to të gjyqtarëve, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit.

30. Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata për pretendimet e kërkuarit në lidhje me formimin e trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e tij, Gjykata e Lartë ka bërë me dije se ajo ka rifilluar funksionimin e saj në mars të vitit 2020, pas emërimit të 3 gjyqtarëve, të cilët me vendimin nr. 2, datë 9.4.2020 të këshillit të kësaj gjykate janë caktuar në përbërje të një prej trupave gjykues të saj. Përbërja e trupave gjykues është riformatuar me vendimin nr. 47/2021 të Këshillit të Gjykatës së Lartë me emërimin e 4 gjyqtarëve të rinj dhe në vijim është riformatuar përsëri me vendimin nr. 56, datë 17.9.2021 (*vendimi nr. 56/2021*) me emërimin e 2 gjyqtarëve të tjerë në muajt korrik dhe shtator të vitit 2021. Po sipas Gjykatës së Lartë, pika 9 e vendimit nr. 56/2021 parashikon se çështjet për të cilat janë caktuar datat e shqyrtimit dhe përbërja e trupit gjykues në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore përfundohen nga trupi gjykues i krijuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Planifikimi i shqyrtimit të çështjes së kërkuarit është bërë në datën 2.8.2021, ndërsa vendimi për çështjen e tij është marrë në datën 16.9.2021. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit se vendimi nr. 47/2021 i Këshillit të Gjykatës së Lartë kishte humbur fuqinë ditën e gjykimit të çështjes së kërkuarit, është i pabazuar, pasi ky vendim ka sjellë efekte deri në datën 17.9.2021, kur është miratuar vendimi nr. 56/2021.

31. Për sa më lart, në vlerësim të dispozitave kushtetuese, ligjore dhe nënligjore, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim trupi gjykues është caktuar në përputhje me këto dispozita dhe se emërimi i gjyqtarëve të rinj nuk përbën shkak për ndryshimin e trupit gjykues.

32. Po kështu, Gjykata konstaton se në ankimin kushtetues individual kërkuar ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërsa në përmbajtje të argumenteve të tij ka pretenduar edhe se Gjykata Administrative e Apelit është shprehur për të drejtën e pronësisë, ndërkohë që çështja është e natyrës administrative, duke tejkaluar kompetencat administrative dhe duke arsyetuar mbi llojin e kredisë dhe ekzekutimin e saj, që i përket gjykatave civile. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata vëren se kontrata e kredisë është analizuar nga Gjykata Administrative e Apelit vetëm për nevojën të gjykimit të çështjes dhe se objekt i gjykimit dhe vlerësimit të saj ka qenë kërkesa e kërkuarit për marrjen e masave mbikëqyrëse dhe veprimeve inspektuese nga Banka e Shqipërisë ndaj ish-Bankës Kombëtare të Greqisë në lidhje me kontratën e kredisë që ai dhe L.Z. kanë nënshkruar me atë bankë. Në arsyetimin e vendimit nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë tejkaluar kompetencat e saj administrative, edhe pse në dukje është marrë në analizë çështja e kredisë (*shih vendimin nr. 11, datë 17.7.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqet 8-9, paragrafët 9.3-9.8*), por kjo ka qenë e nevojshme në funksion edhe të pretendimeve të kërkuarit para

kësaj gjykate. Për më tepër, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk e pengon kërkuesin t'u drejtohet gjykatave civile në lidhje me pretendimet e tij me natyrë civile për kontratën e kredisë.

33. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar.

B.2 Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

34. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për bazueshmërinë në ligj të qëndrimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, çka bën që pjesët e vendimit të saj të mos jenë në harmoni me njëra-tjetrën nga ana formale. Ajo nuk ka përfshirë në vendim nene të cilat të drejtën e reduktimit të kostove të kredisë e njohin si për kredinë konsumatore, ashtu edhe për kredinë hipotekare për individin, çka përbën çështje të vlerësimit të ligjit dhe jo rivlerësim të fakteve. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij se Gjykata Administrative e Apelit ka keqzbatuar kuadrin ligjor në fuqi, pasi ka ngatërruar subjektet të cilave u drejtohet neni 91 i ligjit nr. 9662/2006, si dhe nuk ka respektuar të drejtën për informim sipas vendimit nr. 42, datë 27.6.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në fuqi në atë kohë, duke mos respektuar në këtë mënyrë as hierarkinë e zbatimit të normave. Ndërkohë, Gjykata e Lartë nuk ka interpretuar as literalisht nenin 91 të ligjit nr. 9662/2006 në drejtim të subjekteve që u drejtohet, kufizimeve që vendos në lidhje me informacionin e kërkuar, si dhe subjekteve përfituese të informacionit. Për rrjedhojë, proceduralisht Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar funksionin e saj ligjor rishikues. Vendimi është kontradiktor, jologjik dhe nuk përmban referenca ligjore dhe jurisprudenciale. Mungesa e arsyetimit të vendimit gjyqësor ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike.

35. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ka pretenduar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi në pikat 8, 9 dhe 10 të vendimit Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje për shkaqet e mospranimit të rekursit.

36. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues

dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Nga materialet e dosjes gjyqësore Gjykata konstaton se në datën 18.8.2014 kërkuesi ka paraqitur rekurs ndaj vendimit nr. 11, datë 17.7.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit *(shih dosjen gjyqësore nr. 11/1, datë 4.9.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqet 1-7)*, ndërsa në datën 29.9.2014 subjekti i interesuar ka paraqitur kundërrekurs, për të cilin kërkuesi ka marrë dijeni në datën 6.10.2014. Sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë në datën 2.8.2021 ka njoftuar në faqen zyrtare se rekursi i kërkuesit do të shqyrtohet në datën 16.9.2021 *(shih paragrafin 20 të vendimit)*, ndërkohë kërkuesi ka paraqitur shtesë rekursi në datën 31.8.2021, që është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 2861 prot. *(shih shkruesën e Gjykatës së Lartë dhe materialet bashkëlidhur saj të ndodhura në dosjen gjyqësore nr. 1369 vendimi, datë 16.9.2021 të Gjykatës së Lartë)*.

40. Në rekurs kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë nga Gjykata Administrative e Apelit për shkak se, sipas tij, kjo gjykatë e ka formuar bindjen e saj për çështjen bazuar në prapësimet e paditësit, duke anashkaluar parashikimet ligjore, konkretisht nenin 16 të KPC-së *(shih dosjen gjyqësore nr. 11/1, datë 4.9.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqja 3)*. Ky pretendim i tij është pasqyruar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 2, pika 6)*. Ndërkohë, Gjykata vëren se në shtesën e rekursit kërkuesi ka parashtruar si argument të ri për paanshmërinë e Gjykatës Administrative të Apelit se trupi gjykues i asaj gjykate është caktuar me short manual, në kundërshtim me nenin 1 të vendimit nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të ndryshuar *(shih shtesën e rekursit bashkëlidhur dosjes gjyqësore nr. 1369 vendimi, datë 16.9.2021 të Gjykatës së Lartë, faqja 12)*.

41. Në vendimin e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke arsyetuar, ndër të tjera: “10. Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të palës rekursuese për sa u përket shkelleve ligjore. Këto qëndrime bazohen edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Civil dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.”.

42. Në referim të materialeve të dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se sipas vendimit të kancelarit të Gjykatës Administrative të Apelit “Kalim praktike çështjeje gjyqësore”, shorti për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit nga ajo gjykatë është caktuar në mënyrë manuale *(shih dosjen gjyqësore nr. 11 vendimi, datë 17.7.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqja 1)*, procedurë për të cilën kërkuesi ka ngritur pretendime me natyrë kushtetuese në shtesën e rekursit, në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Po kështu, Gjykata vëren se si nga pikëpamja formale, ashtu edhe nga pikëpamja substanciale, ky pretendim i kërkuesit nuk ka gjetur pasqyrim dhe përgjigje në vendimin e Gjykatës së Lartë për çështjen.

43. Në analizë të sa më lart, Gjykata mban parasysh edhe përmbajtjen e nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se kundërrekursi, së bashku me dokumentet bashkëlidhur, i komunikohet palës që ka bërë rekurs, e cila brenda 7 ditëve ka të drejtë të paraqesë në gjykatë argumente për arsyet e parashtruara në kundërrekursin e depozituar, pa shtuar shkaqe të reja. Megjithatë, në zbatim të standardit të arsyetimit të vendimit, në kushtet kur procedura e shqyrtimit të rekursit është bërë në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, ajo vlerëson se paraqitja nga kërkuesi e shtesës së rekursit në datën 31.8.2021, duhej të ishte evidentuar në vendimin e Gjykatës së Lartë për çështjen, edhe nëse në përfundim nga kjo gjykatë do të konkludohej se shtesa ishte paraqitur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nga ana tjetër, nëse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë do të vlerësonte si të ligjshme paraqitjen e shtesës, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si rrjedhojë e shortimit manual të trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të giente pasqyrim dhe t’i jepej përgjigje në vendim si pretendim i natyrës kushtetuese. Duke mos vepruar në këtë mënyrë, arsyetimi i vendimit të Gjykatës

së Lartë nuk ka përmbushur një ndër funksionet e tij, konkretisht të drejtën e individit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e ngritura.

44. Gjykata vëren, gjithashtu, se si në rekurs, ashtu edhe në shtesën e tij kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për sa i përket zbatimit të ligjit material nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, konkretisht nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006, që përcakton detyrimin e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e sekretit profesional, çka, sipas tij, i ka cenuar të drejtën për t'u njohur me të dhënat e grumbulluara ndaj tij gjatë procesit të mbikëqyrjes së ushtruar nga Banka e Shqipërisë ndaj bankës NBB Albania.

45. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 2 datë 11.2.2021; nr. 1, datë 20.1.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë, në mënyrë që më pas kontrolli kushtetues të rezultojë efektiv, edhe për rastet kur ky interpretim ka cenuar standardet ose parimet kushtetuese. Gjykata ka theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në rastin konkret, qëndrimi i gjykatave të zakonshme për interpretimin e nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006, nëse është pikërisht ky interpretim i tyre mbi ligjin, i cili ka sjellë pasoja antikushtetuese për të drejtat e kërkuesit në drejtim të cenimit të së drejtës për informim për të dhënat e mbledhura për të, do të ndihmonte edhe gjykimin kushtetues.

46. Në vështrim të kësaj analize, Gjykata vëren se edhe pse pretendimi i kërkuesit për keqzbatim të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit, konkretisht të nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006, në drejtim të së drejtës për t'u njohur me të dhënat personale, e garantuar nga neni 35, pika 3, i Kushtetutës, ka gjetur pasqyrim në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021, faqja 3, pika 6, paragrafi i fundit*), analiza e pretendimeve të tij dhe vlerësimi i Gjykatës së Lartë për të, sa i përket faktit se si duhej kuptuar dhe interpretuar ky nen i ligjit nr. 9662/2006 (*shih vendimin nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021, faqja 4, pika 10*), nuk plotësojnë standardin minimal të arsyetimit.

47. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se mungesa e një vendimi të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për shkaqet e lartpërmendura ka vënë në dyshim të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e tij. Në vlerësim të Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, në rastet kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, veçanërisht kur interpretimi i ligjit lidhet me të drejta kushtetuese substanciale të individit. Për më tepër, në rastin konkret, thelbi i procesit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit ka qenë e drejta kushtetuese për informim dhe njohja e kërkuesit me të dhënat e mbledhura rreth tij.

48. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Marrë më 7.7.2022
Shpallur më 29.7.2022

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Elsa Toska, Sandër Beci